



Shkruan: Lulëzim ETEMAJ



PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (PDK) NGRE SHQETËSIMIN SE LUFTA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS NUK PO SULMOHET MË VETËM NË SALLAT E GJYKATËS SPECIALE NË HAGË, POR E NJËJTA NARRATIVË PO TENTOHET TË FUTET EDHE NË BANKAT SHKOLLORE

PDK-ja: GJYKATA SPECIALE KA DEVIJUAR NGA MISIONI I SAJ FAQE 4-5



Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Përparim Gruda, ka mbajtur të premtën një konferencë për medie, në të cilën ka shprehur shqetësimin e thellë të PDK-së lidhur me ligjëratat e mbajtura në shkollat e Kosovës nga përfaqësues të Gjykatës Speciale dhe bashkëpunëtorët e saj. Duke iu referuar ligjëratës së mbajtur nga Gjykata Speciale në gjimnazin "Xhevdet Doda" në Prishtinë, ai ka thënë se tendenca për rishkrimin e historisë në shkollat tona është e papranueshme, duke theksuar se Gjykata Speciale ka devijuar nga misioni i saj

KURTI: KEMI NEVOJË PËR NJË RAPORT TË RI QEVERI - OPOZITË PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT TË KOSOVËS F. 3



PËRURORHET "KLITHMA" E ALKETA GASHI-FAZLIUT

"KLITHMA" E ALKETËS, ZË I FUQISHËM KUNDËR HARRESËS F. 6



AKTUALE



FSK-ja DO TË MARRË PJESË NË FORCËN NDËRKOMBËTARE STABILIZUESE PËR GAZËN F. 2

PECI E VITIA INTERVISTOHEN NGA PROKURORIA SPECIALE F. 2

IKD-ja: MOSORGANIZIMI I PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS SHKEL LIGJIN DHE CENON TË DREJTAT E KANDIDATËVE F. 3

EKONOMI



KËRKOHET RRIJTJA E TARIFAVE TË RRYMËS, ZRRË THOTË SE DO TË APROVOHEN VETËM KOSTOT E ARSYESHME F. 8

AKB-ja: BLOKADAT PO VAZHDOJNË, TREGTIA E BALLKANIT PËRËNDIMOR NËN PRESION POLITIK F. 8

SPORT



MOURINHOS NUK I NDAHET REAL MADRIDIT, BENFICA SËRISH KUNDËR "MBRETËRVE" PAS SHORTIT TË LIGËS SË KAMPIONËVE F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

FSK-ja DO TË MARRË PJESË NË FORCËN NDËRKOMBËTARE STABILIZUESE PËR GAZËN

PRISHTINË, 30 JANAR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të premtën para medieve se Kosova dëshiron të kontribuojë për paqe në botë kudo ku ka nevojë, teksa e ka komentuar pjesëmarrjen e Kosovës në Bordin e Paqes, nismë e presidentit amerikan Donald Trump në kuadër të planit për ta rindërtuar Gazën e shkatërruar nga lufta. Përmes këtij bordi Shtetet e Bashkuara synojnë zgjidhjen e konflikteve globale. Duke folur për herë të parë për Bordin e Paqes, Kurti ka thënë se pjesëmarrja e Kosovës në të është vazhdimësi e kontributit të Kosovës për Gazën, duke nisur me pjesëmarrjen në Forcën Ndërkombëtare Stabilizuese, përmes Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), përkatësisht me gjenerallejtënant komandantin, Bashkim Jashari. “FSK-ja është e mirënjohur tashmë për kërkim-shpëtim dhe për deminim, por jo vetëm”. Kurti i është referuar

pjesëmarrjes së FSK-së në një konferencë të organizuar në dhjetor të vitit 2025 në Doha të Katarit nga Komanda Qendrore e Shteteve të Bashkuara për të diskutuar për Forcën Ndërkombëtare Stabilizuese. “Prandaj kemi qenë të interesuar të marrim pjesë edhe në organet vendimmarrëse politike”, ka thënë mes tjerash Kurti. Forca Ndërkombëtare Stabilizuese është forcë paqeruajtëse shumëkombëshe, me mandat të Kombeve të Bashkuara, e cila parashihet të formohet sipas planit 20-pikësh të Trumpit për paqe në Gazë. Ky plan është pranuar nga Izraeli dhe Hamasi - organizatë e shpallur terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe fuqitë e tjera, në tetor të vitit 2025. Ndonëse nuk janë bërë publike shumë hollësi për Forcën Stabilizuese Ndërkombëtare, ajo besohet se do të ketë mandat për të ofruar siguri dhe për ta mbikëqyrur marrëveshjen e armëpushimit në Gazë.



Shtëpia e Bardhë ka bërë me dije se komandat i kësaj force është emëruar gjeneralmajori i ushtrisë Jasper Jeffers, komandant amerikan i operacioneve speciale. Kurti ka thënë se një prej arsyeve pse Kosova merr pjesë

në iniciativa të tilla është për shkak se edhe ajo vetë ka qenë përfituese e paqes përmes ndërhyrjes së forcave ndërkombëtare. “Sa i përket Gazës, ju e dini që ne i kemi ndarë gjysmë milioni euro si qeveri dhe ky është proces i cili

do të vazhdojë edhe në vijim”. Bordi i Paqes është themeluar më 22 janar në Davos të Zvicrës, në prani të presidentit Trump. Kosova është përfaqësuar nga presidentja Vjosa Osmani. Ky mekanizëm do ta mbikëqyrë udhëheqjen e Rripit të Gazës.

KOMUNAT NË VERI VOTOJNË SËRISH PËR T’U TËRHEQUR NGA ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

MITROVICË, 30 JANAR - Komunitet me shumicë serbe në veri të Kosovës, Mitrovica e Veriut, Leposaviqi dhe Zubin Potoku, kanë votuar për t’u tërhequr nga Asociacioni i Komunave të Kosovës të premtën, pasi duan të jenë pjesë e një asociacioni të veçantë të komunave me shumicë serbe në vend. Kjo është hera e dytë që ato votojnë për këtë pas votimit të 18 dhjetorit të vitit të kaluar. Por, votimi i dhjetorit ishte shpallur i paligjshëm nga ministri në detyrë i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, për shkak të parregullsive procedurale, pasi, ndër të tjera, propozimi ishte bërë nga kryetarët e komunave. “Kjo praktikë bie ndesh me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (neni 47.2), i cili përcakton se vetëm anëtarët



e Kuvendit kanë të drejtë të kërkojnë shtimin e pikave në rendin e ditës gjatë seancës, dhe atë vetëm për çështje urgjente me rëndësi publike”, kishte shkruar Krasniqi në “Facebook” pas votimit të dhjetorit. Ai e kishte kritikuar Listën Serbe se me këtë votim po synonte

“nxitjen e ndasive ndërmjet komuniteteve, përçarjen, mosbesimin dhe tensionet, duke treguar mungesë gatishmërie për të bashkëpunuar me komunat e tjera në kuadër të Asociacionit”. Vendimi i ri i së premtes duhet t’i dërgohet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit

Lokal për aprovim, pasi ajo është organi kryesor mbikëqyrës i komunave. Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku u udhëhoqën nga kryetarë shqiptarë nga maji i vitit 2023 deri në zgjedhjet e tetorit 2025, pasi përfaqësuesit e Listës Serbe kishin dhënë dorëheqje në nëntor të vitit 2022, si pjesë e nismës së përbashkët të serbëve për t’i braktisur institucionet e Kosovës në shenjë kundërshtimi ndaj vendimeve të Qeverisë së Kosovës. Nën udhëheqjen e kryetarëve shqiptarë, këto komuna iu bashkuan Asociacionit të Komunave të Kosovës verën e vitit 2023. Ky asociacion vepron si organizatë joqeveritare me qëllim të shkëmbimit të

përvojave dhe mbrojtjes së interesave të anëtarëve të saj. Lista Serbe e kishte kundërshtuar asokohe anëtarësimin e komunave me shumicë serbe në të, duke vlerësuar se vendimi nuk ishte marrë “në dobi të qytetarëve dhe ishte i paligjshëm”. Asokohe pati reaguar edhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, duke vlerësuar se komunat me shumicë serbe duhet të ishin pjesë e një asociacioni të komunave me shumicë serbe, për themelimin e të cilit Kosova dhe Serbia u pajtuan disa herë gjatë dialogut të tyre nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Kosova nuk ka bërë hapa për ta themeluar këtë asociacion, me gjithë tryshninë nga bashkësia ndërkombëtare.

Peci dhe Vitia intervistohen nga Prokuroria Speciale

PRISHTINË, 30 JANAR - Ish-ministri i Bujqësisë, Faton Peci dhe ministri në detyrë i Shëndetësisë, Arben Vitia, janë intervistuar nga Prokuroria Speciale, në raste të ndara. Peci përmes një postimi në rrjetin social në “Facebook” ka treguar se ka dhënë përgjigje dhe sqarime në kallëzimin penal të ngritur nga LDK-ja. “Përmes këtij postimi, ju informoj se sot isha në

Prokurori për të dhënë përgjigjet dhe sqarimet e mia në kallëzimin penal të ngritur nga LDK-ja përmes ish-deputetit të saj të zgjedhur nga votat e vjedhura të mërgatës, Paris Guri”, ka thënë Peci. Më tutje ai ka thënë se në prokurori ka dhënë shpjegime në lidhje me procesin e granteve të Ministrisë së Bujqësisë. “Në prokurori, sikur gjithmonë gjatë jetës sime, isha transparent, i

qartë dhe i drejtpërdrejtë në lidhje me shpjegimet rreth çështjes dhe rolit që kam pasur si ministër në procesin e granteve të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Shumë shpejt do t’u drejtohem organeve të drejtësisë me një kallëzim penal kundër kallëzimit të rrejshëm penal ndaj ish-deputetit me vota të vjedhura të mërgatës”, thuhet në reagimin e tij.

Peci, po ashtu, tha se këto sulme e akuza nuk e ndalojnë nga punët e mira e të mëdha për Kosovën. Po ashtu, ministri në detyrë i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka pranuar që është intervistuar nga Prokuroria Speciale, edhe pse nuk dha më shumë hollësi. “Por tash nuk mund të ju tregoj njëherë, por shumë shpejt



besoj se do të sqarohet dhe nga Prokuroria Speciale dhe nga ana ime”, tha shkurt Vitia.

KURTI: KEMI NEVOJË PËR NJË RAPORT TË RI QEVERI - OPOZITË PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT TË KOSOVËS

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka thënë të premten se Kosova ka nevojë për një marrëdhënie të re në mes të pushtetit dhe opozitës, në mënyrë që t'i kalojë marrëveshjet jetike ndërkombëtare dhe ta zgjedhë presidentin e ri të vendit, për ta shmangur një krizë të re politike

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 JANAR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se është i gatshëm dhe ka interesim për një bashkëpunim me pozitën, por që a është kjo reciproke, thotë se mbetet të shihet në muajin shkurt, por thekson se duhet të shihet në Kuvend nëse ka atmosferë për një raport të ri qeveri - opozitë.

Kurti para medieve gjatë një vizite që pati në Odën e Mjekëve të Kosovës, theksoi nevojën e bashkëpunimit me opozitën, mirëpo se a do të hapet një kapitull i ri i raporteve të partisë së tij me ta apo do të jetë ajo e vitit 2025, do të shihet në muajin shkurt. Po ashtu, ai tha se është takuar edhe me presidenten, por nënvizoi se para procesit të zgjedhjes së presidentit apo presidentes duhet fillimisht të kalohen tre hapa të tjerë. "Ne duhet të shohim në Kuvend se nëse ka atmosferë për një raport të ri qeveri - opozitë. Unë nuk mund ta them këtë paraprakisht, por pa dyshim muaji shkurt është muaji që do të na tregojë nëse do të mund të hapim një kapitull të ri të raporteve tona. Populli na ka dhënë një mbështetje shumë të madhe, e cila është përgjegjësi e lartë për ne për formimin e qeverisë dhe nuk do të kemi asnjë problem, por për dy të tretat e votave që nevojiten në



Kuvend, prej marrëveshjeve ndërkombëtare deri te zgjedhja e presidentes apo presidentit, ne kemi nevojë për bashkëpunim me opozitën. Nga ana jonë, gatishmëria dhe interesimi ekziston. Në muajin shkurt do të shohim nëse ka gatishmëri dhe interesim nga opozita. Jam kryeministër në detyrë dhe nuk jam ende në mandatin tim të tretë, por kudo

që ka nevojë për paqe në botë, ne dëshirojmë të kontribuojmë, sepse kemi qenë përfitues të paqes në vendin tonë nëpërmjet forcave ndërkombëtare, andaj tani duam të marrim pjesë me forcat tona dhe kapacitetet edhe në paqen në vendet e botës", tha ai.

Kurti përmend hapat deri te çështja e presidentit apo presidentes. "Ndërkaq, sa i

përket takimit me presidenten, jemi në komunikim dhe jemi akorduar, por ta keni parasysh se ai do të jetë hapi i katërt. Pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve dhe trajtimit të të gjitha ankesave të mundshme, kemi nevojë për tre hapa paraprakë. I pari, konstituimi i Kuvendit, që nënkupton zgjedhjen e kryetares apo kryetarit dhe pesë

nënkryetarëve; pastaj formimi i qeverisë; dhe pastaj na duhet që menjëherë të fillojmë me vendimet për marrëveshjet ndërkombëtare. Kemi tri marrëveshje me Bankën Botërore dhe kemi planin e rritjes së BE-së, i cili është në shumën e gjithëmbarshme prej 882.6 milionë eurosh, ku rreth 30 për qind janë grante, ndërkaq 70 për qind janë kredi", theksoi ai.

IKD-ja: MOSORGANIZIMI I PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS SHKEL LIGJIN DHE CENON TË DREJTAT E KANDIDATËVE



PRISHTINË, 30 JANAR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka vlerësuar se Ministria e Drejtësisë (MD) e ka shkelur Ligjin për Provimin e Jurisprudencës dhe ka cenuar të drejtat e kandidatëve duke

mos e organizuar mbajtjen e këtij provimi. Në reagimin e IKD-së është thënë se ligji e përcakton që provimi duhet të organizohet nga Ministria tri herë brenda një viti kalendarik. Sipas IKD-

së, hera e fundit kur Ministria e Drejtësisë ka organizuar Provimin e Jurisprudencës ka qenë afati i prillit 2025. "Gjatë gjithë vitit 2025 MD-ja ka organizuar vetëm këtë afat të provimit, duke mos përmbushur detyrimin ligjor për organizimin e tij në tri afate brenda vitit kalendarik. Në këtë mënyrë deri më tani janë të paktën dy (2), e potencialisht edhe tri (3), afate gjatë të cilave Ministria e Drejtësisë ka qenë e obliguar të organizojë Provimin e Jurisprudencës, por që nuk i ka realizuar", është thënë në reagimin e IKD-së. Më tutje, IKD-ja ka theksuar kjo përveçse është shkelje e ligjit cenon edhe të drejtat e

kandidatëve. "Përtej shkeljes së ligjit, kjo situatë cenon të drejtën në karrierë të juristëve të rinj, të cilët kanë pritje legjitime që procesi i Provimit të Jurisprudencës të organizohet në përputhje me afatet ligjore. Në rrethanat aktuale kandidatët nuk kanë mundësi t'i nënshtrohen këtij procesi, duke u pamundësuar avancimi në karrierë dhe, potencialisht, duke u humbur atyre mundësi konkrete punësimi dhe zhvillimi profesional", është thënë në reagim, duke shtuar se një kategori tjetër e personave të prekur janë kandidatët që kanë mbetur në riprovim. "Përkundër faktit se këta

kandidatë e kanë kaluar pjesën me shkrim të provimit, disa prej tyre kanë mbetur në riprovim në një ose më shumë lëndë. Për shkak të mosorganizimit të Provimit të Jurisprudencës, këta kandidatë e kanë të pamundur ta finalizojnë këtë proces, duke u shkaktuar vonesa dhe dëme të drejtpërdrejta në avancimin e tyre profesional", është thënë në reagimin e IKD-së. IKD-ja i ka bërë thirrje Ministrisë së Drejtësisë që të veprojë menjëherë dhe të organizojë Provimin e Jurisprudencës, siç thuhet, në përputhje të plotë me obligimet ligjore, duke respektuar ligjshmërinë dhe të drejtat legjitime të kandidatëve.



PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (PDK) NGRE SHQETËSIMIN SE LUFTA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS NUK PO SULMOHET MË VETËM NË SALLAT E GJYKATËS SPECIALE NË HAGË, POR E NJËJTA NARRATIVË PO TENTOHET TË FUTET EDHE NË BANKAT SHKOLLORE

PDK-ja: GJYKATA SPECIALE KA DEVIJUAR NGA MISIONI I SAJ

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Përparim Gruda, ka mbajtur të premten një konferencë për medie, në të cilën ka shprehur shqetësimin e thellë të PDK-së lidhur me ligjëratat e mbajtura në shkollat e Kosovës nga përfaqësues të Gjykatës Speciale dhe bashkëpunëtorët e saj. Duke iu referuar ligjëratës së mbajtur nga Gjykata Speciale në gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë, ai ka thënë se tendenca për rishkrimin e historisë në shkollat tona është e papranueshme, duke theksuar se Gjykata Speciale ka devijuar nga misioni i saj

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 30 JANAR - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Përparim Gruda, ka mbajtur të premten një konferencë për medie, në të cilën ka shprehur shqetësimin e thellë të PDK-së lidhur me ligjëratat e mbajtura në shkollat e Kosovës nga përfaqësues të Gjykatës Speciale dhe bashkëpunëtorët e saj. Sipas Grudës, incizimet e publikuara në medie dëshmojnë se gjatë këtyre prezantimeve para nxënësve të mitur është përdorur një gjuhë e papranueshme dhe në kundërshtim me parimet themelore të arsimit dhe të një shoqërie demokratike. “Nxënësve, shumica nën moshën 18-vjeçare, u janë paraqitur pretendime të

njëanshme, duke u etiketuar ish-krerët e UÇK-së si kryerës të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit. Kjo është skandaloze dhe e papranueshme”, theksoi Gruda. Ai paralajmëroi se lufta çlirimtare e Kosovës nuk po sulmohet më vetëm në sallat e Gjykatës Speciale në Hagë, por se e njëjta narrativë po tentohet të futet edhe në bankat shkollore. “Lufta jonë po sulmohet edhe nga bankat dhe klasat e shkollave tona, por e vërteta jonë nuk mund të tjetërsohet në emër të ‘drejtësisë’ selektive, as të deformohet kujtesa kolektive në emër të ‘edukimit,’” tha ai. Deputeti i PDK-së theksoi se shqetësimi i partisë është shumëdimensional. Ai përmendi rrezikun e indoktrinimit të nxënësve,

përplekjet për rishkrimin e historisë së Kosovës, si dhe shkeljen e parimit të prezumimit të pafajësisë. “Toni i përdorur në këto prezantime i trajton Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin si fajtorë, duke paragjykuar vendimin përfundimtar. Gjykatat e vërteta merren me drejtësi, jo me propagandë”, deklaroi Gruda. Ai shtoi se kjo Gjykatë ka devijuar nga misioni i saj fillestar. “Ajo është dashur të ndihmojë në zbardhjen e së vërtetës dhe në heqjen e njollave ndaj UÇK-së, por është shndërruar në një mekanizëm që tenton ta rishkruajë historinë”, u shpreh ai. PDK-ja kërkon sqarim urgjent se kush është përgjegjës për këto ligjërata dhe si ka ndodhur që prezantime të paraqitura si ligjërata për të drejtat e fëmijëve të shndërrohen në mesazhe politike. “Kërkojmë llogari nga Ministria e Arsimit për mënyrën se si lejohet që kushdo t’u ligjërojë nxënësve në shkollat e Kosovës, pa mbikëqyrje institucionale dhe pa standard profesional”, theksoi Gruda. Në këtë kontekst, ai tha se marshi i paralajmëruar për 17 shkurt, me moton “Drejtësi, jo politikë”, është një reagim i natyrshëm në momentin kur procesi në Hagë ka hyrë në fazën finale.

Në përmbyllje, Gruda theksoi qëndrimin e palëkundur të PDK-së. “Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi janë pjesë e historisë sonë të lavdishme çlirimtare. Ata nuk janë fajtorë për asnjë krim. PDK qëndron fuqishëm në mbrojtje të tyre, në mbrojtje të UÇK-së dhe në mbrojtje të së vërtetës për Kosovën”, përfundoi Gruda. Edhe ish-nënkryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj, ka komentuar të premten ligjëratën e mbajtur nga Gjykata Speciale në gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë. Ai në “Klan Kosova” tha se e njëjta gjykatë ka dhënë vendime të gabueshme dhe të padrejta duke iu referuar rastit të Salih Mustafës-Calit dhe atij të Pjetër Shalës. “Kjo gjykatë ka dhënë vendime të gabueshme, të padrejta, dhe tani që janë të plotfuqishme siç është rasti i Calit dhe Pjetër Shalës dhe vendimi për ne që na ka dënuar”, ka pohuar ai. Haradinaj, mes të tjerash, ka theksuar se problem i ligjëratës së Speciales ka qenë propaganda kundër UÇK-së. “Problemi ka qenë propaganda kundër UÇK-së. Këto ligjërata nuk mund t’i bëjë askush pa marrë një leje”, ka thënë Haradinaj. SBASHK-u, OVLUÇK-ja, KMDLNj dhe komuna e Prishtinës kanë kundërshtuar ligjëratën e Gjykatës Speciale në

Gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë. Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka shprehur shqetësim se ligjëratat që lidhen me Gjykatën Speciale nëpër shkolla në Kosovë mund të jenë përpjekje për të ndikuar në opinionin publik dhe të nxënësit kundër UÇK-së dhe ish-krerëve të saj që po gjykohen në Hagë. Me moton “Drejtësi, jo politikë”, do të protestohet më 17 shkurt në orën 14:00 në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, që qëllim ka vetëm mbrojtjen e çlirimtarëve të cilët po mbahen në Hagë. Protesta do të organizohet nga platforma “Liria ka Emër”, ku gjatë një konference për medie, Eliza Hoxha e Ismail Tasholli kanë theksuar se data 17 shkurt nuk është zgjedhur rastësisht, por se ajo përkon me Ditën e Pavarësisë së Kosovës dhe me momentin historik të shpalljes së saj, duke e bërë këtë protestë një akt simbolik dhe qytetar në mbrojtje të parimit të drejtësisë. Platforma “Liria ka Emër” ka vlerësuar se procesi gjyqësor në Hagë, i cili ka hyrë në fazën përmbyllëse pas më shumë se pesë vjetësh, ka krijuar shqetësime serioze në opinionin publik. Zvarritja e procedurave, kompleksiteti i tyre, informacionet kontradiktore, si dhe perceptimi i ndikimit politik, kanë cenuar besimin qytetar se drejtësia po trajtohet si një proces thjesht juridik.

KOSOVA FORMON GRUP PUNE PËR ZBATIMIN E LIGJEVE PËR TË HUAJT DHE AUTOMJETET

PRISHTINË, 30 JANAR - Qeveria e Kosovës ka mbledhur një grup zyrtarësh nga institucionet shtetërore, në të cilin bëjnë pjesë ekspertë ligjorë dhe të tjerë, me qëllim të adresimit të çështjeve që dalin nga zbatimi i Ligjit për të Huajt dhe Ligjit për Automjete, konfirmoi për Radion Evropa e Lirë zëdhënësi i Qeverisë në detyrë të Kosovës, Përparim Kryeziu. “Roli dhe përgjegjësia e këtij grupi është të qartësojë kërkesat që parashohin ligjet, në të njëjtën kohë edhe angazhimin e shtetit në raport me subjektet që preken nga ligjet, me qëllim lehtësimin e zbatimit të plotë të tyre”, tha ai, por nuk saktësoi se kush bën pjesë në këtë grup pune. Kryeziu theksoi se përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar në Kosovë veçse janë njoftuar me këtë grup dhe “kanë zhvilluar takime fillestare”. Më herët, Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë që ka mbështetjen e Beogradit, ka bërë me dije se për këto çështje ka zhvilluar dhjetëra takime me përfaqësues ndërkombëtarë, duke thënë se ndërkombëtarët kanë vendosur që të “formojnë edhe një ekip të veçantë ekspertësh që merret me zgjidhjen e këtij problemi”. Radio Evropa e Lirë iu drejtua Bashkimit Evropian dhe vendeve të QUINT-it me pyetje nëse kanë marrë pjesë në formimin e ekipit të ekspertëve, por ata nuk kanë kthyer përgjigje. Faza e parë e zbatimit të plotë të Ligjit për të Huajt dhe atij për Automjete ka nisur më 16 janar dhe do të zgjasë deri 15 mars. Gjatë kësaj periudhe parashihet një fushatë informuese për

qytetarët lidhur me dy ligjet. Zbatimi i këtyre rregullave që dalin nga këto ligje do të prekë pjesëtarët e komunitetit serb që jetojnë në Kosovë, të cilët deri më tani kanë drejtuar me autorizim automjete me targa të ndonjë qyteti në Serbi ose që nuk kanë dokumente të Kosovës. Një grup organizatash joqeveritare serbe njoftoi më 23 janar, se lidhur me paralajmërimin për zbatimin e plotë të Ligjit për të Huajt dhe Ligjit për Automjetet, ka biseduar me përfaqësues të misionëve diplomatike në Kosovë dhe i ka ftuar ata për një angazhim më të madh për këtë çështje. Nisma e Re Shoqërore, Qendra për Veprime Afirmative Shoqërore, Aktiv dhe Instituti për Zhvillim Ekonomik Territorial i kanë bërë thirrje bashkësisë ndërkombëtare që të insistojnë në “konsultime të gjera dhe gjithëpërfshirëse me komunitetin serb, që do të përfshinin përfaqësues relevantë politikë, shoqërinë civile dhe komunitetin akademik, si parakusht për çfarëdo hapash të mëtejme lidhur me këto korniza ligjore”. Ndërkaq udhëheqësi i partisë Për liri, drejtësi dhe mbijetesë, Nenad Rashiq, u ka bërë thirrje të gjithë aktorëve politikë në Kosovë, veçanërisht Listës Serbe, që “të marrin përgjegjësi dhe të përfshihen në mënyrë aktive në hartimin e propozimeve juridiko-teknike”, me qëllim që të sigurohet tranzicioni në zbatimin e Ligjit për të Huajt dhe Ligjit për Automjetet. Rashiqi vlerësoi se është përgjegjësi e politikanëve të gjejnë forma se si “në mënyrë



efikase dhe racionale të përshtatemi me zbatimin e tyre”. Në anën tjetër, Lista Serbe përmes një reagimi tha se Rashiqi “pa asnjë legjitimitet dhe mbështetje nga populli serb merr pjesë në pushtetin e Albin Kurtit dhe voton për të gjitha masat që janë të drejtuara kundër serbëve në Kosovë dhe Metohi”. Rashiqi ka qenë ministër në qeverinë e Albin Kurtit pasi Lista Serbe në nëntor të vitit 2022 u largua nga institucionet e Kosovës. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, Lista Serbe fitoi nëntë nga dhjetë vendet e rezervuara për komunitetin serb në Kuvend, ndërkaq Rashiqi fitoi një. Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, më 16 janar deklaroi se, krahas zbatimit të Ligjit për të Huajt dhe Ligjit për Automjetet, është i domosdoshëm integrimi i institucioneve shëndetësore dhe arsimore serbe, duke shtuar se procesi do të zbatohet në koordinim me Bashkimin

Evropian dhe se do të merren parasysh shqetësimet e komuniteteve joshumicë. Institucionet arsimore dhe shëndetësore në komunitetet serbe në Kosovë funksionojnë brenda sistemit të Serbisë dhe janë pothuajse të vetmet që autoritetet e Kosovës nuk i kanë mbyllur gjatë dy vjetëve të fundit në kuadër të aksionit për mbylljen e institucioneve serbe, pasi Prishtina i konsideron ato paralele dhe ilegale. Punonjësit e këtyre institucioneve, veçanërisht profesorët dhe studentët në Universitetin e Mitrovicës së Veriut, mund të përballen me probleme kur të nisë zbatimi i plotë i Ligjit për të Huajt sepse, sipas udhëzimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të publikuar më 16 janar, të gjithë ata që nuk kanë dokumente të Kosovës duhet të kenë leje pune ose licencë për punë, për të cilën kërkesa dorëzohet pranë Agjencisë Kosovare për Punësim.

Në praktikë kjo do të thotë se institucionet arsimore dhe shëndetësore të sistemit serb duhet të kenë licencë nga institucionet e Kosovës. Udhëzimi i MPB-së saktëson gjithashtu se për qëllime studimi, bashkim të familjes, arsye humanitare, kërkime shkencore dhe rrethana të tjera të parashikuara me ligj, nevojitet posedimi i lejes për qëndrim të përkohshëm dhe plotësimi i kushteve të tjera të përcaktuar në ligj, në varësi të qëllimit të qëndrimit. Gjithashtu, parashikohet që shtetasit e huaj në Kosovë mund të qëndrojnë deri në 90 ditë, ndërsa çdo qëndrim më i gjatë kërkon dorëzimin e kërkesës për leje qëndrim. Nëse dikush shkel këto rregulla, organet kompetente mund të ndërmarrin masa të parashikuara me ligj, të cilat mund ta përfshijnë heqjen e lejes së qëndrimit, gjobitje, dëbim ose ndalim të hyrjes në territorin e Kosovës.

KUSH I SOLLI LIGJËRUESIT E GJYKATËS SË HAGËS NË PRISHTINË?!



Lulëzim ETEMAJ

Procesi gjyqësor në Hagë kundër katër krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, deri më tani ka dëshmuar se Prokuroria e kësaj gjykate po përpiket t'i mbështesë krimet e pretenduara mbi fabrikime të ofruara nga Serbia si dhe nga dëshmitarë të ndryshëm: të fshehtë, të manipuluar dhe injorantë. Ndërkohë, në anën tjetër, të kundërtën- realitetin e luftës në Kosovë - e kanë dëshmuar qartë faktorë të shumtë ndërkombëtarë: politikë, diplomatikë, ushtarakë e të sigurisë,



përfshirë edhe NATO-n. Në këtë kontekst, mbajtja e ligjërates nga zyrtarë të Gjykatës së Hagës para

nxënësve të Gjinnazit “Xhevdet Doda” në Prishtinë, më 22 janar 2026, lidhur me krimet e pretenduara të UÇK-

së, përbën një precedent të rëndë dhe të papranueshëm. Ky veprim bëhet edhe më i rëndë kur dihet fakti se këta nxënës i përkasin një vendi që ka përjetuar nga Serbia gjenocid të dokumentuar, gjurmët e të cilit janë të pranishme kudo. Ligjërata të tilla nuk janë mbajtur as gjatë dhe as pas gjykimit në Hagë të Slobodan Millosheviqit, përgjegjësit për gjenocidin në Bosnjë e Kosovë, si dhe krimet në Kroaci. Prandaj, lindin pyetjet legjitime për opinionin publik: - Kush i solli ligjëruesit e Gjykatës së Hagës në Prishtinë? - Kush i drejtoi ata në Gjinnazin “Xhevdet Doda”? - Kush e përzgjedhi klasën ku u

mbajt ligjërata? Në një shoqëri që respekton sa duhet sakrificat, luftën dhe përkushtimin për çlirim, liri dhe pavarësim, Drejtoria e Arsimit e Prishtinës dhe drejtoria e Gjinnazit “Xhevdet Doda” do të ishin të obliguara, brenda 24 orësh, të japin përgjigje publike dhe të qarta për këto pyetje. Të merresh vetëm me Gjykatën e Hagës, deformimet dhe anomalitë e saj, si dhe shkeljen e të drejtave më elementare njerëzore të krerëve dhe pjesëtarëve të tjerë të UÇK-së, duke anashkaluar rolin e institucioneve vendore të arsimit dhe përgjegjësinë e tyre, vetëm sa e mjegullon çështjen dhe e shmang llogaridhënien.

PËRURORHET “KLITHMA” E ALKETA GASHI-FAZLIUT

“KLITHMA” E ALKETËS, ZË I FUQISHËM KUNDËR HARRESËS

Moderatorja dhe poetja Alketa Gashi-Fazliu ka përruar të premten në Prishtinë, në Institutin Albanologjik, librin “Klithma”, i cili trajton krimet serbe të kryera ndaj popullit shqiptar, me theks të veçantë vuajtjet e fëmijëve gjatë luftës në Kosovë, duke sjellë rrëfime që sfidojnë harresën dhe kërkojnë drejtësi. Në përrurimin e këtij libri kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve, studiues, profesorë, akademikë dhe personalitete të jetës publike. Libri “Klithma” është vlerësuar si zë i fuqishëm kundër harresës dhe artefakt i vuajtjeve të popullit shqiptar të Kosovës

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

PRISHTINË, 30 JANAR - Në Institutin Albanologjik në Prishtinë të premten është përruar libri “Klithma” dhe është hapur ekspozita po me këtë emër i autores Alketa Gashi-Fazliu. Salla ishte e vogël në Institutin Albanologjik për t’i zënë mysafirët të cilët kanë marrë pjesë në përrurimin e këtij libri, i cili është

gjenocidin që ka kryer Serbia ndaj shqiptarëve të Kosovës. Ndërsa ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Petrit Malaj, ka thënë se “Klithma” i autores Alketa Gashi-Fazliu është një zë i fuqishëm kundër harresës. Ai ka lartësuar profesionalizmin dhe përkushtimin etik që ka treguar autorja Gashi-Fazliu në librin “Klithma”. “Në faqet e këtij botimi nuk gjenden vetëm tregime, por zëra fëmijësh që u ndërprejnë

faktit me ndjeshmëri të rrëfimit letrar. “Ajo nuk shkruan për të na tronditur neve, por për të mos lejuar harresën. Nuk shkruan për të nxitur urrejtje, por për ta përruar të vërtetën”, ka thënë Malaj. Në anën tjetër, akademik Pëllumb Xhufi e ka vlerësuar librin “Klithma” si dëshmi e rëndësishme historike mbi vuajtjet dhe rezistencën e popullit shqiptar. Xhufi ka thënë se libri “Klithma” ka prekur qelizën me të ndjeshme, atë të fëmijëve ndaj të cilëve është ushtruar gjenocid

e kombit shqiptar. “Alketa nuk është historiane, por shpesh bën këtë punë”, ka thënë Keçmezi-Basha, duke shtuar se libri “Klithma” nuk është vetëm klithmë në letër, por klithmë për një popull të terë. “... është thirrje për të mos harruar, për të mos heshtur dhe për të mos u pajtuar me harresën”, ka thënë ajo. Kurse publicisti Aleksandër Çipa ka thënë se libri “Klithma” është një artefakt historik ku pasqyron vuajtjen dhe persekutimin e shqiptarëve të Kosovës. “Është një

Gashi-Fazliu. Ajo ka thënë se qëllimi i këtij libri është t’u përcillet brezave të rinj e vërteta për krimet dhe gjenocidin e ushtruar nga Serbia ndaj shqiptarëve. Gashi-Fazliu ka thënë se “Klithma” është ndërgjegje kolektive që nuk duhet të heshtë. “Në shtëpinë time lufta nuk do të përfundojë asnjëherë dhe ju e dini për çfarë po flas. Unë ditë e natë përballem me plagët e barbarit serb që ka shkaktuar mbi fëmijët, mbi të rinjtë e të rejt, mbi njerëzit e kësaj toke. Fëmijëve ua kujtoj çdo ditë e çdo natë se si duhet ta duan tokën e tyre, gjuhën e tyre dhe dheun e tyre. Në qoftë se mendoni që mund të kem bërë diçka dhe kam gjak shqiptari në deje, kjo është falë prindërve të mi që i kam aty, që çdo ditë, çdo natë, vite me radhë dhe vazhdueshëm na i kanë përsëritur mua, vëllezërve dhe motrës që kjo është toka juaj dhe nëse është nevoja, duhet ta lini edhe kokën. Uroj që mos të vijë ajo ditë, por nënë dhe baba faleminderit që erdhët nga Gjermania... ‘Klithma’ nuk është zhurmë dhe nuk dua të bëj zhurmë. ‘Klithma’ është ndërgjegje dhe uroj që të na përcjellë gjatë”, ka thënë Gashi-Fazliu.

Në promovimin e librit “Klithma” aktori Xhevat Limani ka interpretuar një fragment nga ky libër duke u dhënë zë emocioneve dhe klithmës së fëmijëve të pafajshëm të cilët kanë pësuar nga regjimi gjenocidal i Serbisë.



vlerësuar si artefakt historik i vuajtjeve nëpër të cilat ka kaluar populli shqiptar i Kosovës. Në përrurimin e librit “Klithma” morën pjesë edhe ish-presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, ambasadori i Shqipërisë në Prishtinë, Petrit Malaj, heroina Vasfije Krasniqi, përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, ish-drejtuës të luftës së UÇK-së, publicistë, studiues, profesorë, akademikë dhe personalitete të jetës kulturore dhe diplomatike. Libri “Klithma” përmbledh tetë rrëfime që dëshmojnë dhunën barbare të serbëve ndaj fëmijëve shqiptarë, duke sjellë rrëfime që sfidojnë harresën dhe kërkojnë drejtësi. Humanistja Flora Brovina, dëshmitare e drejtpërdrejtë e krimeve të luftës, në përrurimin e këtij libri ka ndarë përvoja tronditëse nga ajo periudhë, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së kujtesës historike për viktimat e pafajshme. Ajo e ka përrgëzuar Alketa Gashi-Fazliun për nxjerrjen në dritë të krimeve që kanë ndodhur gjatë luftës në Kosovë. Brovina ka thënë se edhe në të ardhmen duhet të botohen libra të tillë të cilët nxjerrin në pah

dhunshëm nga historia. Histori që mbajnë brenda dhimbjen e pafajësisë së shkelur dhe plagën e hapur të një krimi që ende kërkon drejtësi. Klithma është thirrja e atyre që nuk patën mundësi të rriten, të ndërrojnë dhe të jetojnë. Autorja Alketa Gashi-Fazliu, pa dyshim një emër i njohur, i respektuar i gazetarisë, ka dëshmuar gjithë këto vite një përkushtim profesional dhe etik, me ndjeshmëri njerëzore, me integritet, me guxim”, ka thënë Malaj, duke shtuar se autorja Gashi-Fazliu nëpërmjet këtij libri ka arritur ta bashkojë fuqinë e



nga Serbia. Për këtë libër të veçantë, Xhufi ka falënderuar Gashi-Fazliun. Më tutje, historiania Sabile Keçmezi-Basha, duke folur për librin “Klithma”, ka thënë se autorja Alketa Gashi-Fazliu është zë që depërton thellë ndërgjegjen

artefakt dhe një histori, është një vitalitet njerëzor që thotë: edhe pse jetën e kam të gjymtuar, jetën do ta bëj të bukur”, ka thënë publicisti Çipa. Krejt në fund dhe e emocionuar ka mbajtur një fjalë rasti edhe autorja e librit “Klithma”, Alketa



Departamenti i Shtetit i ShBA-së vlerëson sukseset e Shërbimit Korrektues të Kosovës

PRISHTINË, 30 JANAR - Në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Ismail Dibrani, priti në takim Kyle Conahan, zyrtar i Departamentit të Shtetit të ShBA-së nga Zyra për Kundërterrorizëm. Gjatë takimit Dibrani i informoi për zhvillimet, të arriturat dhe sukseset e

Shërbimit Korrektues të Kosovës si në nivelin vendor po ashtu edhe në atë ndërkombëtar, me theks të veçantë në rolin dhe avancimin e Njësisë së Inteligjencës së ShKK-së. Po ashtu, drejtori Dibrani falënderoi për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme, duke theksuar se falë përkrahjes së partnerëve ndërkombëtarë, në veçanti

Departamentit të Shtetit të ShBA-së, Shërbimi Korrektues i Kosovës sot është lider në rajon si për nga trajtimi, po ashtu edhe për nga siguria, gjithashtu edhe shembull i suksesit dhe model për t'u ndjekur nga vendet e rajonit. Në takim u diskutua edhe për çështjet që lidhen me kundërterrorizmin, bashkëpunimin ndërinstitucional dhe forcimin e sigurisë.



POLICIA E KOSOVËS REALIZON VIZITËN E PARË NË KUFIRIN SHBA - MEKSIKË NË PORTIN E HYRJES LAREDO

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 JANAR - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, i shoqëruar nga udhëheqës të lartë nga PK, realizoi vizitën e parë zyrtare të Policisë së Kosovës në kufirin në mes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Meksikës. Delegacioni vëzhgoi nga afër operacionet e sigurisë kufitare në kohë reale në Portin e Hyrjes Laredo, në bashkëpunim me Doganat dhe Mbrojtjen Kufitare të ShBA-së dhe zyrtarët kufitarë. Vizita u organizua me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në



Prishtinë përmes DOJ-ICITAP. Kjo vizitë historike shënoi herën e parë që zyrtarë të Policisë së Kosovës kanë vëzhguar drejtpërdrejt procedurat operative në disa pika të kalimit

kufitar ShBA - Meksikë. Delegacioni shprehu vlerësim të lartë për mundësinë për t'u njohur nga afër me praktikën e sofistikuar të CBP-së dhe Patrullës Kufitare të menaxhimit

kufitar, përdorimin e teknologjive moderne dhe qasjet e koordinuara të zbatimit të ligjit të përdorura në një nga pikat më të ngarkuara të hyrjes në Shtetet e Bashkuara. Gjatë vizitës përfaqësuesit e Policisë së Kosovës ndoqën operacionet në kohë reale, përfshirë procedurat e inspektimit, metodat e kontrollit të bazuara në vlerësimin e rrezikut si dhe integrimin e teknologjisë për forcimin e sigurisë kufitare, njëkohësisht duke lehtësuar tregtinë dhe udhëtimin. Këto përvoja u vlerësuan lart si në aspektin e njohurive praktike dhe janë mësim të vlefshme që mund të përshtaten për forcimin e

operacioneve të sigurisë kufitare në Kosovë. Policia e Kosovës vlerëson shumë lart vizitën, njohuritë dhe përvojat e fituara që do të kontribuojnë në planifikimin e ardhshëm dhe iniciativat për ngritjen e kapaciteteve, përfshirë bashkëpunimin e vazhdueshëm me Ambasadën e ShBA-së në Kosovë për avancimin e standardeve të sigurisë kufitare dhe rritjen e efektivitetit operacional. Kjo vizitë nënvizon partneritetin e fuqishëm ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara dhe pasqyron përkushtimin e përbashkët ndaj sigurisë kufitare, inovacionit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

UP-JA DËRAGON MBI 160 STUDENTË NË MOBILITET ERASMUS+ DREJT UNIVERSITETEVE EVROPIANE DHE JAPONEZE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 30 JANAR - Para udhëtimit drejt universiteteve të përzgjedhura evropiane nëpërmjet programit Erasmus+, studentët që përfitojnë nga kjo mundësi u takuan në rektorat me drejtuesit e Universitetit të Prishtinës. Në semestrin veror 2026, mbi 160 studentë të Universitetit të Prishtinës do ta nisin mobilitetin e tyre drejt universiteteve evropiane, në kuadër të programeve të bashkëpunimit ndërkombëtar si dhe drejt universiteteve japoneze. Studentët e UP-së që do të shkojnë për një semestër në universitete ndërkombëtare, u zotuan se do ta promovojnë Universitetin e

Prishtinës në vendet ku do të studiojnë, duke krijuar ura të reja miqësie. Studentja Poema Efendia, që do të studiojë në Universitetin e Giessenit të Gjermanisë, falënderoi Universitetin e Prishtinës dhe Departamentin e tij për Bashkëpunim Ndërkombëtar për mundësinë e dhënë, duke u dëshiruar fat e suksese kolegeve e kolegëve në këtë përvojë të re e sfiduese. Studenti i Fakultetit të Mjekësisë, Ardi Blakaj, që studioi për disa muaj nëpërmjet programit të BE-së Erasmus+ në Universitetin e Parias në Itali, tregoi përvojat e veta nga atje, duke i cilësuar thesar të çmuar miqësitë që krijoi gjatë kësaj përvoje. Blakaj tha se është kthyer nga Italia si një



person tjetër, më i përgatitur për jetë dhe me vetëbesim më të madh, teksa ndau me të pranishmit edhe fotografi nga përjetimet e tij. Rektori prof. Arben Hajrullahu u

dëshiroi studentëve shtim të aftësive akademike dhe shkathtësive për jetë, duke i porositur që ta shfrytëzojnë kohën e mundësive të jashtëzakonshme e të pakufishme në të cilën po

jetojmë. Prorektorja Rozafa Basha përvojat që do të fitojnë studentët nga studimet në Evropë e përtej i cilësoi transformuese. Ajo i konsideroi këta studentë ambasadorë të Universitetit të Prishtinës, ndërsa u shpreh e bindur se ata do të përçojnë vlerat e UP-së dhe Kosovës kudo, me dinjitet dhe përgjegjësi. Ngjarja u drejtua nga koordinatorja e programit Erasmus+ në Universitetin e Prishtinës, Afërdita Rexhepi dhe u organizua nga Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Universitetin e Prishtinës. Studentët u porositën që gjithsesi ta marrin me vete në përvojat e tyre jashtë vendit flamurin e Kosovës.

Mitrovica drejt ndërtimit të spitalit të ri modern

MITROVICË, 30 JANAR - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Faton Peci, i shoqëruar nga nënkryetari Enis Osmani, kanë pritur në takim ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia, si dhe drejtorin e Spitalit të Përgjithshëm të Mitrovicës, Gëzim Berisha. Gjatë takimit u diskutua për

sektorin e shëndetësisë në përgjithësi, me fokus të veçantë në projektet që Ministria e Shëndetësisë planifikon ta realizojë në komunën e Mitrovicës. Në këtë kuadër u trajtua edhe ecuria dhe dinamika e projektit madhor për ndërtimin e spitalit të ri në

Mitrovicë. Kryetari Faton Peci ka bërë me dije se spitali i ri pritet të ndërtohet me hapësira moderne dhe me të gjitha shërbimet shëndetësore, ndërsa implementimi i tij do të fillojë sapo të formohet qeveria. Po ashtu, u shqyrtua edhe

mundësia e zhvendosjes së ambulancave specialiste nga Spitali i Përgjithshëm i Mitrovicës në hapësira më të përshtatshme dhe më moderne të QKMF-së. Peci theksoi se komuna e Mitrovicës do t'i përbushë të gjitha obligimet që i takojnë, në mënyrë që ky projekt



madhor të jetësohet sa më parë.

TRANSPORTUESIT NGA SERBIA DHE BOSNJA VAZHDOJNË BLOKADAT NË PIKAT KUFITARE

PRISHTINË, 30 JANAR - Transportuesit nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina po i vazhdojnë bllokadat në pikat kufitare me Bashkimin Evropian për të pestën ditë me radhë. Ndërkohë, kolegët e tyre nga Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut kanë hequr dorë prej këtyre masave më 29 janar, pasi Komisioni Evropian bëri me dije se po punon në një strategji të re për viza që parasheh zgjidhjen e problemit të ditëve të kufizuara për punëtorët e vendeve të treta që duhet të hyjnë në Zonën Schengen. Terminalet për mallra janë bllokuar në 22 pika dalje dhe 19 pika hyrëse vetëm në Serbi. Transportuesit e mallrave janë duke protestuar kundër atyre që i konsiderojnë procedura të ashpra për të hyrë në Zonën Schengen, të cilat, sipas tyre, ua kanë shkurtuar kohën e qëndrimit në shtetet e Bashkimit Evropian. Ata kërkojnë që periudha e qëndrimit të zgjatet nga tre në katër muaj brenda një periudhe gjashtëmuajore.



Paralajmërimet fillestare ishin që bllokadat të zgjasnin për të paktën shtatë ditë, në rast se nuk arrihet ndonjë marrëveshje. Presidenti i Dhomës së Tregtisë në Serbi, Marko Çadezh, ka thënë në ditën e parë të bllokadave se dëmi direkt ditor që u shkaktohet ekonomive të Ballkanit Perëndimor shkon në rreth 100 milionë euro. Strategjia e re e vizave, që është

miratuar nga Komisioni Evropian më 29 janar, parasheh që institucioni të punojë nga afër me vendet anëtare për të gjetur “zgjidhje pragmatike” dhe të miratojë zgjatje të qëndrimit për disa kategori të shtetasve që vijnë nga shtetet e treta. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë ka thënë të premten se mirëpret heqjen e bllokadave nga kompanitë

transportuese të rajonit, referencë për Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. “Ky është një hap pozitiv drejt normalizimit të qarkullimit të mallrave dhe funksionimit të zinxhirëve të furnizimit për bizneset e Kosovës, pasi këto bllokada shkaktuan vonesa të konsiderueshme në import dhe eksport, rritje të kostove operative për kompanitë dhe pasiguri për sektorë të tërë ekonomike në vend”, ka thënë

Dhoma e Tregtisë e Kosovës përmes një komunikate për medie. Kosova nuk ka marrë pjesë në protestë, mirëpo i ka vërejtur pasojat e saj, pasi pjesën më të madhe të importit dhe eksportit e realizon përmes transiteve nëpër këto vende. Disa biznese të Kosovës me të cilat ka biseduar Radio Evropa e Lirë kanë thënë se ditë e fundit janë përballur me vonesa, rrezikim kontratash dhe dëme financiare.

Çfarë është sistemi EES?

I njohur si EES (Entry/Exit System), ky sistem u vendos në kufijtë e jashtëm të zonës Schengen dhe nisi të zbatohej gradualisht më 12 tetor 2025. Ai pritet të jetë plotësisht funksional deri më 10 prill 2026. Rregulli i ashtuquajtur “90/180 ditë” parasheh që transportuesit nga vendet jashtë Schengenit mund të qëndrojnë në këtë zonë maksimumi 90 ditë brenda një periudhe prej 180 ditësh.

KËRKOHET RITJIA E TARIFAVE TË RRYMËS, ZRRE THOTË SE DO TË APROVOHEN VETËM KOSTOT E ARSYESHME

PRISHTINË, 30 JANAR - Tre operatorët energjetikë në Kosovë kanë kërkuar rritjen e tarifave të energjisë elektrike për vitin 2026. Rritja e çmimit të rrymës është kërkuar nga Operatori për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO), Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe Kompania për Distribuim të Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS), që kanë dërguar këto kërkesa në Zyrën e Rregullatorit për Energji në Kosovë (ZRRE). KESCO ka kërkuar rritje mbi 20 për qind të tarifave të energjisë elektrike për vitin 2026, duke u thirrur në rritjen e kostove operative dhe nevojën për sigurim të furnizimit të qëndrueshëm me energji. Sipas

aplikimit të dorëzuar në ZRRE, KESCO ka kërkuar që të hyrat e lejuara maksimale për vitin e ardhshëm të jenë 528.78 milionë euro. “Pas marrjes në konsideratë të shpenzimeve të pritshme për vitin e ardhshëm, kërkesa për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026 është 528.78 milionë euro”, thuhet në aplikimin që kjo kompani ia ka dorëzuar ZRRE-së. Vitin e kaluar KESCO kishte kërkuar të hyra të lejuara maksimale rreth 448 milionë euro, ndërsa ZRRE-ja kishte aprovuar rreth 436 milionë euro. Si arsye për rritjen e kërkuar nga KESCO përmenden shpenzimet operative, kostoja e importit të energjisë, rritja e sigurisë së furnizimit gjatë sezonit

dimëror, si dhe rritja e pagave të punëtorëve. Ndërkaq, KEDS-i ka kërkuar 235 milionë euro apo 21 milionë euro më shumë sesa kërkesa fillestare e vitit të kaluar që ishte 214 milionë euro. Ndërsa vitin e kaluar ZRRE-ja i kishte aprovuar këto të hyra në vlerën prej 180.653 milionë euro. Kurse kërkesa e KOSTT-it, që thotë se synon të ofrojë shërbime më cilësore për konsumatorët, është mbi 99 milionë euro, nga rreth 102 milionë euro sa ishte vitin e kaluar. Vitin paraprak ZRRE-ja kishte aprovuar këto të hyra në vlerën prej 88 milionë eurosh. ZRRE-ja bën çdo vit shqyrtimin dhe caktimin e tarifave të energjisë elektrike, të cilat shpallen më 1 prill dhe vlejnë



deri më 31 mars të vitit pasues. Vitin e kaluar ZRRE-ja kishte miratuar rritje të tarifave për 16.1 për qind krahasuar me vitin paraprak. Sipas tarifave aktuale, konsumatorët që shpenzojnë deri në 800 kilovatë në orë në muaj paguajnë 9.05 centë për kilovat, ndërsa ata që shpenzojnë mbi këtë prag

paguajnë 15.43 centë për kilovat. Kurse tarifat e lira që shfrytëzohen gjatë natës nga ora 23:00 deri në 08:00 të mëngjesit, konsumatorët për një kilovat paguajnë 3.88 centë për ata që shpenzojnë deri në 800 kilovatë. Ndërkaq, ata që shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë paguajnë 7.28 centë për kilovat.

AKB-ja: Bllokadat po vazhdojnë, tregtia e Ballkanit Perëndimor nën presion politik



PRISHTINË, 30 JANAR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka theksuar se tërheqja nga protestat e transportuesve në Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut nuk nënkupton arritje të marrëveshjes, por është rezultat i presionit të drejtpërdrejtë të Bashkimit Evropian. Sipas AKB-së, problemet mbesin të

pazgjidhura dhe kërkesat e transportuesve nuk janë adresuar në mënyrë substanciale. “Ndërkohë, vazhdimi i protestave në Serbi dhe Bosnjë-Hercegovinë po vazhdon ta pengojë qarkullimin e mallrave, duke dëmtuar rëndë tregtinë e Kosovës me vendet e Ballkanit

Perëndimor dhe me Bashkimin Evropian. Aleanca Kosovare e Bizneseve vlerëson se kjo situatë është e papranueshme, cenon parimet e tregut të lirë dhe po shkakton dëme serioze ekonomike për bizneset e Kosovës dhe ato të Ballkanit. AKB-ja kërkon reagim urgjent institucional, koordinim

rajonal dhe ndërhyrje konkrete të BE-së për t'i plotësuar kërkesat e transportuesve dhe për të garantuar lëvizje të lirë të mallrave dhe trajtim të barabartë për transportuesit e Ballkanit Perëndimor. Heshtja dhe zvarritja e EU-s nuk janë më opsion”, thuhet në reagimin e AKB-së.

“DREJTËSIA PA LLOGARIDHËNIE”, THIRRJE SERIOZE PËR TRANSPARENCË DHE RESPEKT TË DINJITETIT NJERËZOR



Shtëpia botuese “Armagedoni” ka lëshuar sot në shtyp librin “Drejtësia pa llogaridhënie : Raporti Marty, Dhomat e Specializuara dhe deformimi i drejtësisë” të autorit Ibish Neziri. Njoftimin për botimin e librit e ka publikuar në rrjete sociale drejtori i kësaj shtëpie, Berat Armagedoni, i cili ka bërë edhe një përshkrim të shkurtër për përmbajtjen e librit: “Librin e Ibish Nezirit, në gjuhën shqipe dhe angleze, e lëshuam sot në shtyp. Sot një javë, një mijë ekzemplarë do t’i nxjerrim nga shtypi. Po i paraprijmë marshit demonstrues të 17 shkurtit me një protestë me fjalë, me dëshmi dhe me fakte. Libri ‘Drejtësia pa llogaridhënie : Raporti Marty, Dhomat e Specializuara dhe deformimi i drejtësisë’ i Ibish Nezirit është një analizë kritike, e strukturuar dhe juridikisht e argumentuar mbi një nga çështjet më të ndjeshme të pasluftës në Kosovë: funksionimin dhe legjitimitetin e Dhomave të Specializuara në Hagë. Autori nuk ndalet në

trajtimin sipërfaqësor të debatit publik, por e vendos temën në një kornizë më të gjerë normative, institucionale dhe morale, duke e ballafaquar praktikën konkrete të kësaj gjykate me standardet e së drejtës evropiane dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Neziri argumenton se Dhomat e Specializuara janë produkt i një procesi politik të nisur nga Raporti i Dick Martyt dhe se juridiksioni i tyre selektiv ka prodhuar një drejtësi asimetrike, e cila rrezikon të deformojë jo vetëm parimet themelore të drejtësisë penale, por edhe kujtesën historike të luftës së Kosovës. Në qendër të kritikës së autorit qëndron mungesa e llogaridhënies institucionale, paraburgimi i tejzgjatur shumëvjeçar, refuzimi i mbikëqyrjes së jashtme dhe shkelja e standardeve të Nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Këto fenomene trajtohen jo si raste të izoluara, por si pasojë e një vendimi

institucional ndërkombëtar, i cili ka normalizuar përjashtimin procedural dhe ka relativizuar të drejtat themelore të njeriut. Vlera e veçantë e librit qëndron në qasjen e tij të matur dhe të përgjegjshme: autori nuk synon të mohojë krime individuale, as të ndërhyjë në procese gjyqësore konkrete, por kërkon barazi normative, proporcionalitet dhe koherencë morale në zbatimin e drejtësisë. Duke kombinuar përvojën personale të jetës në sisteme të ndryshme politike me përvojën profesionale si gazetar dhe redaktor në medie perëndimore, Neziri arrin të ndërtojë një diskurs kritik që është njëkohësisht racional, juridik dhe qytetar. “Drejtësia pa llogaridhënie” është një kontribut i rëndësishëm në debatin publik dhe akademik mbi kufijtë e drejtësisë penale ndërkombëtare dhe mbetet një thirrje serioze për transparencë, mbikëqyrje dhe respekt të dinjitetit njerëzor në emër të një drejtësie reale, e jo thjesht formale”.

STARMER FIRMOS MARRËVESHJE ME KINËN PAS VIZITËS NË PEKIN, TRUMP 'NDEZ ALARMIN': KJO ËSHTË SHUMË E RREZIKSHME PËR MB, KUJDES TË KETË EDHE KANADAJA

Pas mbërritjes së së kryeministrit Keir Starmer në Shanghai, Presidenti Donald Trump ka deklaruar se është shumë e rrezikshme që Mbretëria e Bashkuar të bëjë 'biznes' apo të lidhë marrëveshje me Kinën. Trump iu referua Xi si një "mik" dhe tha se e njihnte presidentin kinez "shumë mirë". Në përgjigje të vërejtjeve të Trump, Doëning Street tregoi se Uashingtoni kishte qenë në dijeni të këtij udhëtimi dhe objektivave të tij

paraprakisht. Po ashtu theksohej se vetë presidenti amerikan do të vizitonte vetë Kinën në prill. Presidenti i SHBA-së u pyet nga një gazetar se "çfarë mendoni për hyrjen e Mbretërisë së Bashkuar në marrëdhëne biznesi me Kinën?" Përtej komenteve të tij të shkurtra, Trump nuk tha asgjë më tej rreth angazhimit të Mbretërisë së Bashkuar me Kinën, duke u përqendruar në

Kanada dhe duke dhënë një paralajmërim të ngjashëm. Ai tha se ishte "edhe më e rrezikshme për Kanadanë". "Kanadaja nuk po ecën mirë. Po ecën shumë keq dhe nuk mund ta shohësh Kinën si përgjigjen", shtoi ai. Më herët këtë javë, presidenti amerikan kërcënoi se do të vendoste tarifa ndaj Kanadasë nëse ajo do të vazhdonte me marrëveshjet ekonomike të arritura me Kinën gjatë një vizite

të kohëve të fundit në Pekin nga kryeministri i saj, Mark Carney. Komentet vijnë pasi Starmer tha se marrëdhënia e Mbretërisë së Bashkuar me Kinën ishte e mirë dhe e fortë pas bisedimeve të tij me Xi. Deri më tani, nga udhëtimi i Keir Starmer kanë dalë disa rezultate, përfshirë një marrëveshje për udhëtimin pa viza dhe tarifatat më të ulëta të uiskit, si dhe një investim prej 10.9 miliardë funtash nga AstraZeneca për të

ndërtuar objekte prodhuese në Kinë. U njoftuan gjithashtu marrëveshje për bashkëpunim të mëtejshëm në fusha të tjera, të tilla si krimi i organizuar dhe imigracioni i paligjshëm. SHBA-të ishin partneri më i madh tregtar i Mbretërisë së Bashkuar në vitin 2025, ndërsa Kina ishte e katërta më e madhe, sipas Departamentit për Biznes dhe Tregti.



KTHESË HISTORIKE NË VENEZUELË, PARLAMENTI HAP TREGUN E NAFTËS PËR PRIVATËT, MERR FUND MONOPOLI 25-VJEÇAR I ÇAVIZMIT

Venezuela, vendi me rezervat më të mëdha të naftës në botë, ka marrë një vendim që shënon fundin e një epoke ideologjike dhe ekonomike. Parlamenti i vendit miratoi këtë të enjte (29 janar 2026) një reformë radikale që i hap dyert kapitalit privat në sektorin e naftës, duke zhbërë kështu politikën e "kontrollit të ngurtë shtetëror" të vendosur nga Hugo Çavez dhe pasuesit e tij

prej më shumë se çerek shekulli. Ligji, i cili kaloi në lexim të dytë në Asamblenë Kombëtare, tashmë pret vetëm vulën finale: nënshkrimin ekzekutiv nga Presidentja e përkohshme de facto, Delcy Rodríguez, për të hyrë zyrtarisht në fuqi. Ajo që e bën këtë vendim historik është fakti se u votua nga vetë Partia Socialiste e Bashkuar e Venezuelës (PSUV), forca politike

e themeluar nga Çavez, e cila gëzon shumicën në Asamble. Deputetët socialistë, të cilët për dekada kanë shtetëzuar asete dhe kanë demonizuar kapitalin privat në sektorin strategjik energjetik, miratuan liberalizimin e tregut. Kjo lëvizje shihet nga vëzhguesit ndërkombëtarë si një pranim i heshtur i dështimit të modelit të centralizuar, i cili, i kombinuar

me sanksionet dhe keqmenaxhimin, e kishte çuar industrinë e naftës të Venezuelës (PDVSA) drejt kolapsit total teknik dhe financiar. Masa e re ligjore thyen tabunë e madhe të Çavizmit. Shteti nuk do të jetë më i vetmi operator në fushat naftëmbajtëse. Kompanitë ndërkombëtare dhe investitorët privatë do të kenë të drejtë të zotërojnë aksione dhe të

menaxhojnë operacione, me shpresën për të sjellë kapitalin dhe teknologjinë e munguar. Tani sytë janë drejtuar nga pallati presidencial "Miraflores", ku Delcy Rodríguez pritet të hedhë firmën që do të zyrtarizojë këtë ndryshim drastik kurs, në një përpjekje për të ringjallur "zembrën" e ekonomisë venezueliane në vitin 2026.





Zyrtare: Kristjan Asllani, futbollisti më i ri i Besiktasit

BESIKTAS, 30 JANAR - Kristjan Asllani është gati të kryejë një hap të rëndësishëm në karrierën e tij, teksa do të kalojë testet mjekësore te Besiktasi dhe më pas do të paraqitet te klubi i njohur turk. Mesfushori shqiptar do të jetë shok

skuadre me Milot Rashicën, duke shtuar përvojën dhe cilësinë në mesfushën e ekipit turk. Asllani është aktualisht futbollist i Interit, por gjatë pjesës së parë të sezonit ishte i huazuar te Torino. Te torinezët

mesfushori shqiptar nuk gjeti hapësirat e kërkuara dhe vendosi të largohej, duke hapur rrugën për transferimin në Turqi. "Kristjan Asllani, futbollist profesionist me të cilin kemi nisur negociatat e transferimit, ka arritur në

Stamboll për t'i vazhduar bisedimet dhe për t'i kryer testet mjekësore", ka shkruar Besiktas në rrjetet sociale. Transferimi i Asllanit te Besiktasi pritet ta përforcojë mesfushën e skuadrës dhe të sjellë më shumë opsione për



gigantin turk në gjysmën e dytë të sezonit.

MOURINHOS NUK I NDAHET REAL MADRID, BENFICA SËRISH KUNDËR "MBRETËRVE" PAS SHORTIT TË LIGËS SË KAMPIONËVE

NYON, 30 JANAR - Në Nyon të Zvicrës është hedhur shorti i Ligës së Kampionëve për 16 skuadrat që marrin pjesë në fazën play-off të turneut. Benfica do të përballet sërish me Real Madridin, teksa para disa ditësh e kishte mposhtur me shifrat e thella 4-2 ku ka spikatur goli i portierit Trubin në minutën e 98. Juventus ka përballë gigantin turq, Gallatasarayin, ndërsa PSG-ja do të luajë ndaj francezëve të Monakos, në derbin francez në Evropë. Atalanta e Berat Gjimshitiut do ta sfidojë Borussia Dortmundin, ndërsa Interi do ta ketë përballë

Bodo/Glimt. Rikujtojmë që ndeshjet e "play-off"-it do të luhen më 17-18 shkurt dhe 24-25 shkurt. Po ashtu në Nyon të Zvicrës është tërhequr edhe shorti i "play-off"-it të fazës nokaut në Ligën e Evropës, që është niveli i dytë i garave kontinentale. Dinamo e Zagrebit do të përballet me Genkun belg. Ndërkohë prej ndeshjeve më interesante pritet të jenë ato ndërmjet Fenerbahçes dhe Nottingham Forestit dhe Celticut me Stuttgartin. Çiftet e tjera të "play-off"-it janë: Ludogorets - Ferencvarosh,

Brann - Bologna, Panathinaikos - Viktoria Plzen, PAOK - Celta dhe Lille - Cërvena Zvezda. Ndeshjet e para do të luhen më 19 shkurt, kurse ato kthyesë një javë më pas.

SHORTI I LIGËS SË KAMPIONËVE:

Benfica - Real Madrid
Bodo/Glimt - Inter
Qarabag - Newcastle
Monaco - PSG
Club Brugge - Atletico Madrid
Galatasaray - Juventus
Olympiacos - Bayer Leverkusen
Borussia Dortmund - Atalanta



SUPER NDESHJE NË SUPERLIGË, BASHKIMI E PRET PRISHTINËN

PRISHTINË, 30 JANAR - ProCredit Superliga në fundjavë premton ndeshje shumë interesante. Java e 18 do të hapet me derbin ndërmjet skuadrave me traditë, e që gjithashtu do të ndeshen në gjysmëfinale të Kupës, Bashkimi dhe Sigal Prishtina. Prizrenasit janë në vendin e dytë me 11 fitore e 6 humbje, kurse prishtinasit kanë 8 fitore e 9 humbje, duke bërë që të pritet një sfidë e jashtëzakonshme. Takim shumë i rëndësishëm do të zhvillohet ndërmjet GO+ Pejës dhe Rahoveci 029. Pejanët kanë 8 fitore e 9 humbje, kurse

"Vreshtarët" pesë fitore e 12 humbje, çka e bën këtë përballje jetike për të dyja skuadrat. Ndeshje shumë e rëndësishme do të zhvillohet mes Vëllaznimit dhe Borës. Kuqezinjtë kanë pesë fitore e 12 humbje, në anën tjetër prishtinasit janë në formë të lartë me 9 fitore e 8 humbje. Xhiroja e 18 do të mbyllet me përballjen ndërmjet Trepçës dhe Golden Eagle Yllit. Dy skuadrat ndodhen në formë të jashtëzakonshme me mitrovicasit që kanë 9 fitore radhazi në elitë, kurse therandasit kanë 5 fitore

radhazi në ProCredit Superligë. Këto dy skuadra u përballën në çerekfinale të Kupës, që përfundoi me kalimin e 'Xehetarëve' në gjysmëfinale. Mitrovicasit kanë 14 fitore e 3 humbje, kurse therandasit 8 fitore e 9 humbje.

PROCREDIT SUPERLIGA - JAVA 18:

Sot (e shtunë)
17:00 Bashkimi - Sigal Prishtina
19:30 GO+Peja - Rahoveci 029

Nesër (e diel)
17:00 Vëllaznimi-Bora
19:30 Trepça-Golden Eagle Ylli



FFK-ja hap kurs për Licencën kombëtare C për trajnerë të portierëve

PRISHTINË, 30 JANAR - Departamenti i Edukimit në Federatën e Futbollit të Kosovës (FFK) i ka njoftuar të interesuarit se kursi i radhës për Licencën kombëtare C për trajnerë të portierëve do të

organizohet nga 9 deri më 12 mars 2026 në Kampin Nacional në Hajvali. Sipas FFK-së, pjesëmarrësit do të mësojnë teknikat bazë dhe të avancuara për portierët dhe do t'i nënshtrohen një provimi

praktik. Çmimi i këtij kursi kushton 200 euro dhe do të pranohen vetëm 24 kandidatë. "Aplikimet (online ose dokumentet e kompletuara) pranohen deri më 15 shkurt 2026 në:

departamentiteknik@ffk-kosova.com. Të gjitha detajet e kursit dhe dokumentet e nevojshme për aplikim gjenden në uebfaqen tonë zyrtare: www.ffc-kosova.com", ka njoftuar FFK-ja.



NJOFTIM

Njoftojmë se kompania "SUNPOWER KOSOVA SHPK" nga Gracanica, me numër unik identifikues 810143420 ka marrë vendim për mbyllje të biznesit.

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët afarist që kanë raporte Debitore-Kreditore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

NOTIFICATION

We inform all customers that the company "SUNPOWER KOSOVA SHPK" with address in Gracanica, has decided to close the business with unique identification number 810143420, and has appointed the liq-uidator for the development of the liquidation procedure. All clients who have Credit-Debt reports in this company are notified to appear within 30 days from the date of publication in the newspaper.

OBAVEŠTENJE

Obaveštavamo svu klientelu da je kompanija "SUNPOWER KOSOVA SHPK", sa adresom Gracanica, odlučila da pestaje radni aktivnost sa jedinstvenim identifikacionim brojem 810143420, i imenovao likvidatora za razvoj postupka likvi-dacije. Svi klijenti koji imaju kreditno-debitne izveštaje u ovoj kompaniji su obavešteni da se pojave u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Dendron Alliance” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811485904 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Dendron Alliance” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811485904 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Dendron Alliance” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 811485904 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë se kompania "RAMJAN SOLAR SHPK" nga Prishtina, me numër unik identifikues 811877705 ka marrë vendim për mbyllje të biznesit.

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët afarist që kanë raporte Debitore-Kreditore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

NOTIFICATION

We inform all customers that the company "RAMJAN SOLAR SHPK" with address in Prishtina, has decided to close the business with unique identification number 811877705, and has appointed the liq-uidator for the development of the liquidation procedure. All clients who have Credit-Debt reports in this company are notified to appear within 30 days from the date of publication in the newspaper.

OBAVEŠTENJE

Obaveštavamo svu klientelu da je kompanija "RAMJAN SOLAR SHPK", sa adresom Prishtina, odlučila da pestaje radni aktivnost sa jedinstvenim identifikacionim brojem 811877705, i imenovao likvidatora za razvoj postupka likvi-dacije. Svi klijenti koji imaju kreditno-debitne izveštaje u ovoj kompaniji su obavešteni da se pojave u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me operatorin "Erti” Sh.p.k. Skenderaj, kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot. 25/7990/MMPHI/685/DMMU, për veprimtarinë: Thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror, Dresnik, Klinë, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t’u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 26.02.2026, në ora: 11:00, në hapësirat e Zyres së kompanisë Erti shpk në Dresnik, Komuna e Klinës, do të organizohet debat publik nga operatori "Erti” Sh.p.k. Skenderaj, kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot. 25/7990/MMPHI/685/DMMU, për veprimtarinë: Thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror, Dresnik, Klinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:
<https://us04web.zoom.us/j/5289487423?pwd=atEPUrNDxCwMcX5GSCHJS7NmAu7JDN.1>

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPHI-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=Erti>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

"Erti” Sh.p.k.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

